



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KESHILLI BASHKIAK DIBER

VENDIMI 116 Date 15.09.2020

“Për miratim e investimeve nga fondet e World Vision Albania”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit “ , i ndryshuar ,si dhe VKM 408 datë 15.03.2015 “Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit “ ,i ndryshuar, **si dhe bazuar ne Marreveshjen e Bashkepunimit Nr.2733 Prot datë 06.08.2020 “Për projektet e ndërhyrjeve në shkolla “ të nënshkruar midis Bashkisë Dibër dhe World Vision Albania”**: Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij, datë 15.09.2020 me 18 vota pro 1 vota kundër.

VENDOSI :

1. Të miratohen investimet e mëposhtme nga “Marreveshja e Bashkëpunimit Nr.2733 Prot datë 06.08.2020 “Për projektet e ndërhyrjeve në shkolla “ të nënshkruar midis Bashkisë Dibër dhe World Vision Albania”:
2. “Ndërhyrje dhe ndërtimi i hapësires sportive, shkolla 9-vjeçare Vranjt” me vlerë financimi 243,000 lekë me Tvsh.
3. “Përmiresimi i infrastruktures në shkollë për të rritur gjithë përfshirjen dhe standartet e mësimdhënies, shkolla “Idriz Kaba” Tomim, me vlerë financimi 319,600 lekë me Tvsh.
4. “Shtrimi i klasave me pllaka për përmirësim të aksesit të fëmijëve në ambientet e shkollës 9-vjeçare Sohodoll me vlerë financimi 352,500 lekë me Tvsh.
5. “Krijimi i një hapësire / ambienti për aktivitete gjithë përfshirëse, shkolla 9-vjeçare “Selim Alliu” Peshkopi me vlerë financimi 379,351 lekë me Tvsh.
6. “Krijimi i një ambienti të brendshëm sportiv në shkollën “Demir Gashi”, shkolla 9-vjeçare “Demir Gashi”, Peshkopi me vlerë financimi 354,616 lekë me Tvsh.

- Totali i vlerës investimeve 1,649,067 lekë me Tvsh.

2. Pakesohet fondi nga të ardhurat për Bashkinë Dibër nga akt-rakordimi i muajit Gusht 2020 (transfertë e ardhur nga World Vision Albania) dhe shtohet për strukturën buxhetore 6260 llogaria 602 në vlerën 1,649,067 (një milion e e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Urbanistikës, Sektori i Prokurimeve, Sektori i Finances dhe World Vision Albania sipas detyrave të percaktuara në kontratën mes paleve .

Adresa: Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi, Albania, Nr.tel 003552182166

10/10/2019

4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

KRYETAR KËSHILLI

